



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-III-12-1102

Paditësi

NPK, Prishtinë, përfaqësuar nga avokati **H.H.**

kundër

E paditura

QSHKSE, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, më 7 tetor 2019, merr këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Aktvendimi i DHPGJS mbi pezullimin e procedurës, i datës 30 gusht 2016, me këtë rast çfuçizohet.**
- 2. Dhoma e Posaçme nuk ka kompetencë të mëtutjeshme për të vendosur për këtë çështje.**
- 3. Lënda i referohet Gjykatës Themelore të Prishtinës për vendosje.**
- 4. Gjykata nuk ka caktuar shpenzimet gjyqësore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me 25.06.2012 Paditësi ka parashtruar padi në DHPGJS.

Me 08.12.2015 AKP ka parashtruar mbrojtje.

Me 21.12.2015 E paditura ka parashtruar mbrojtje.

Me 06.01.2016 Paditësi ka parashtruar përgjigje në mbrojtjen e AKP-së dhe në mbrojtjen e të paditurës.

Me 15.01.2016 AKP ka parashtruar përgjigje në përgjigjen e paditësit.

Me 16.06.2016 AKP ka njoftuar DHPGJS për fillimin e procedurës së likuidimit të N.SH.-së të paditur.

Me 30.08.2016, Kolegji i Specializuar, bjen Aktvendim, me të cilin ka pezulluar procedurën lidhur me këtë lëndë.

Padia:

- Padiësi kërkon kompensim në të holla, shumë në lartësi prej 384,034.-Euro me kamatë ligjore të llogaritur nga 25.02.2000 deri në ditën e pagesës, për dëmin e shkaktuar nga zjarri që ka ndodhur me 25 dhe 26.02.2002, dhe shpenzimet e procedurës.

Mbrojtja:

- Mbrojtja e AKP-së dhe përgjigjja në përgjigje të padiësit:

AKP në mbrojtje e kundërshton padinë dhe thotë se në bazë të kontratës mbi dhënien me qira të depove e lidhur ne mes të padiësit si qiramarrës dhe të paditurës si qiradhënës, qiramarrësi ka qenë i obliguar që të siguroj mallin nga të gjitha rreziqet, në të kundërtën rreziku për dëme eventuale bie në padiësin.

Në përgjigjen në përgjigje AKP propozon që padia të hedhet poshtë si e papranueshme ose të refuzohet si e pa bazuar.

- Përgjigjja e të paditurës:

E paditura në mbrojtjen e saj i propozon DHPGJS që të refuzon padinë si të pa bazë pasi që obligimi i padiësit (qiramarrësit) ka qenë që të pajiset me aparate për fikjen e zjarrit dhe të ndërmer masat e tjera për evitimin e rrezikut nga zjarri.

- Përgjigjja e padiësit në mbrojtjet:

Padiësi deklaron se mbrojtjet e AKP-së dhe të paditurës nuk kanë mbështetje ligjore dhe mbështetje faktike dhe propozon DHPGJS që mbrojtjet të refuzohen si të pabazuara.

Kolegji i specializuar, me 30 gusht 2016, bjen aktvendimin e saj me anë të së cilës ka pezulluar procedurën me arsyetim se ndaj të paditurës ishte hapur procedura e likuidimit nga ana e AKP.

Përfaqësuesi i padiësit, parashton disa parashtrës, me të cilat ndër të tjerash kërkon vazhdimin e procedurës gjyqësore.

Arsvetimi ligjor:

Çfuçizimi i vendimit mbi pezullimin e procedurës

Me atkëndimin e DHPGJS të datës 30 gusht 2016, procedura është pezulluar sipas nenit 10.1 të të Shtojcës së Ligjit mbi AKP Nr. 04/L-034, sepse AKP si administruese kishte inicuar procedurën e likuidimit të paditurës.

AKP – ka parashtruar një parashtrësë, pranë DHPGJS me 17 shtator 2017.

AKP - Autoriteti i Likuidimit PRN067 - Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike , respektivisht Agjencia Kosovare e Privatizimit informon publikun e gjerë dhe të gjitha institucionet tjera relevante publike se: duke filluar nga kjo datë, autoriteti i likuidimit, respektivisht Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka kurrfarë autorizimi dhe nuk merr asnjë përgjegjësi në lidhje me këtë ndërmarrje, pronën, kreditorët, detyrimet, punonjës të saj ose ndonjë veprim apo mosveprim në emër dhe për llogari të kësaj ndërmarrje.

Nga arsyet e lartëcekura gjykata gjeti se kanë pushuar kushtet ligjore mbi pezullimin e procedurës ndaj të paditurës, pasi që e paditura nuk gjindet më nën administrimin e AKP.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

Jurisdikcioni DHPGJS

Sa i përket juridiksionit të DHPGJS-së, kjo rregullohet me nenin 5 të LDHP-së, dhe neni 6 i LDHP-së, i cili përcakton se kush mund të jetë paditës, respektivisht i paditur në procedurat para DHPGJS-së.

I/të paditur sipas nenit 6, nën-paragrafi 2.2 të LDHP-së sipas zgjedhjes së Agjencisë është Ndërmarrja, e cila është nën administrimin e Agjencisë apo Agjencia e cila vepron në emër të ndërmarrjes në fjalë.

Prandaj, DHPGJS duke u bazuar në parimet ligjore sipas dispozitës së përmendur nuk ka juridiksion.

Megjithatë, në bazë të nenit 6.2, alinea 2.5, të LDHP-së i paditur në procedurat para DHPGJS-së është, “*në kuptim të cilësdo lëndë apo çështje para saj*”, mund të jetët çdo person që DHPGJS-ja e konsideron të nevojshëm apo të përshtatshëm për ta emëruar apo pranuar si të paditur në mënyrë që të sigurojë “*gjykimin e plotë dhe të tërësishëm*” të asaj lënde apo çështjeje.

Nga të gjitha arsyet e cekura si më lartë po ashtu sipas dispozitës së sipërpërmendur të Ligjit mbi DHPGJS, është e qartë se e paditura, mund të shtohet si i paditur në lëndë, vetëm nëse tanimë ekziston një lëndë e cila është në pritje për t’u zgjidhur pranë DHPGJS-së, një (apo më shumë) të paditurit që bien nën përkufizimin e dhënë në nenin 6.2 të LDHP-së. Në të kundërtën, DHPGJS nuk ka juridiksion mbi një çështje nëse ndërmarrj është palë e vetme në një lëndë.

Për më tepër më, 17 shtator 2018, Agjencia Kosovare e Privatizimit dorëzoi një njoftim në Dhomën e Posaçme duke e informuar gjykatën se me Vendimin nr. 07-21, të 22.12.2017, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe me Vendimin Nr. 06-V-080 të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së pranim dorëzimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, më 11 shtator 2018, është kryer dorëzimi i PRN067 – QSKESë Prishtinës. Kjo Marrëveshje për pranim dorëzim shoqërohet me anekset si dhe me dokumentacionin e duhur që mundëson vazhdimin e punës dhe ecurinë e veprimtarisë së ndërmarrjes publike lokale PRnën menaxhimin e Komunës së Prishtinës.

Prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet

Lënda është referuar për vendosje pranë Gjykatës Themelore, si gjykatë kompetente, andaj nuk janë caktuar shpenzimet gjyqësore.

Këshilla ligjore:

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Afati i përcaktuar kohor fillon në mesnatën e ditës, kur pala përkatëse ka marrë vendimin me shkrim. Ankesa së bashku me Aktvendimin e ankimuar duhet gjithashtu të dorëzohet tek palët tjera nga Ankuesi, brenda të njëjtit afat kohor.

Në pajtim me nenin 9 paragrafi 8 i Ligjit për DHPGJS, në rast se pala parashtron ankesën, pala tjetër e procedurës mund të dorëzojë përgjigje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, që nga data e dorëzimit të apelit tek ajo, duke parashtruar përgjigjen tek ankuesi dhe palëve tjera (nëse ka),

Siç përcaktohet në nenin 68 paragrafi 1.2, lidhur me nenin 38.3 të Ligjit për DHPGJS, parashtruesi i ankesës ka shtatë (7) ditë afat, pas dorëzimit të përgjigjejes ndaj ankesës së tij, të parashtrorë përgjigjen e tij ndaj asaj përgjigjeje tek Kolegji i Apelit dhe ta dorëzojë atë tek pala tjetër.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar